



VENDIM

Nr. 27 Datë 16. 02.2015

**MBI MIRATIMIN E TARIFËS FIKSE TË ENERGJISË, PËR VITIN
2015, QË DO T'I PAGUHET PRODHUESVE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; Nenit 15, pika 3, të Ligjit nr 138/2013 “Për burimet e energjisë së rinovueshme” të ndryshuar, Nenit 111, të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.125, datë 11.02.2015 “Për miratimin e metodologjise të përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do t'i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”; Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar; Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.02.2015, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve mbi tarifën fikse të shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e energjisë elektrike për vitin 2015,

Vendosi :

1. Tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t'i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2015, do të jetë **7.636 leke/kWh**.
2. Vendimi nr.5, datë 26.01.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjise së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, dhe Vendimi nr. 24, datë 11.04.2007, i Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjise së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW” shfuqizohen.
3. Ngarkohet KESH sh.a. dhe Prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere dhe i shtrin efektet e tij nga 01.01.2015 deri më 31.12.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s

Petrit AHMETI

